



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 11 shkurt 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi parashtrimet në lidhje me kategorizimin sipas rregullës 109(c)**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**  
Xhonatan Elistan Ris  
Hju Bouden

**Mbrojtësit të Nasim Haradinajt**  
Tobi Kadman  
Karl Bakli

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 95(2)(b) dhe 109(c) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 dhe 26 shtator 2020, Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinaj (“z. Haradinaj”) (së bashku, “Mbrojtja” ose “të akuzuarit”) u arrestuan<sup>2</sup> në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë,<sup>3</sup> në përputhje me fletarrestimet dhe urdhrat për transferim.<sup>4</sup>

2. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmoi pjesërisht aktakuzën e dorëzuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),<sup>5</sup> dhe më tej ZPS-ja parashtroi aktakuzën e rishikuar që u konfirmua.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik. Para këtij vendimi, Kryetarja kishte caktuar të njëjtin gjykatës si Gjykatë të Vetëm; shih KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik; F00016, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Hysni Gucatit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale. F00020, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i versionit të korrigjuar të fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00074/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës (“Vendimi i konfirmimit”)*, 11 dhjetor 2020, publik.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00075/A02, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e redaktuar*, 14 dhjetor 2020, publike.

3. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje lidhur me to” (“Vendimi kornizë mbi nxjerrjen e provave”), në të cilin e shtyu vendimin e vet për formatin dhe kohën e tabelave të nxjerrjes së materialit në përputhje me kriteret e kategorizimit sipas rregullës 109(c) të Rregullores dhe urdhëroi ZPS-në që të dorëzonte propozim të përbashkët për ato tabela deri më 1 shkurt 2021.<sup>7</sup>

4. Më 1 shkurt 2021, ZPS-ja dhe Mbrojtja dorëzuan propozimin e përbashkët të kërkuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, të cilit i bashkëngjitën një model të tabelës në përputhje me rregullën 109(c) të Rregullores (“tabela e propozuar”).<sup>8</sup>

## II. PARASHTRIMET

5. Palët kanë arritur marrëveshje të pjesshme mbi qasjen në lidhje me tabelën që do të dorëzohet në përputhje me rregullën 109(c) të Rregullores, por nuk janë në gjendje të arrijnë pajtueshmëri të plotë.<sup>9</sup> Palët pajtohen për formatin<sup>10</sup> dhe nivelin e kategorizimit të tabelës së propozuar<sup>11</sup> si dhe për kategorizimin e fushave të meta të dhënave në *Legal WorkFlow*.<sup>12</sup> Sa i përket kohës së nxjerrjes së tabelës<sup>13</sup> dhe llojit të materialit me të cilin ka të bëjë,<sup>14</sup> nuk është arritur asnjë marrëveshje.

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje lidhur me to* (“Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave”), 22 janar 2021, publik, para. 66, 85(1).

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, F00109, Gjykatësi i Vetëm, *Parashtrim i Kategorizimit sipas rregullës 109(c)* (“Parashtrimi”), 1 shkurt 2021, publik, me shtojcën 1 (“tabela e propozuar”), publike.

<sup>9</sup> Parashtrimi, para. 2.

<sup>10</sup> Parashtrimi, para. 3.

<sup>11</sup> Parashtrimi, para. 4.

<sup>12</sup> Parashtrimi, para. 9.

<sup>13</sup> Parashtrimi, para. 3, 6-7.

<sup>14</sup> Parashtrimi, para. 5-6.

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me rregullën 95(2)(b) të Rregullores, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit në pajtim me rregullën 92 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake cakton afatet për nxjerrjen e provave dhe merr masa për të garantuar nxjerrje të provave me kohë.

7. Në përputhje me rregullën 109(b) dhe (c) të Rregullores, edhe ZPS-ja edhe Mbrojtja, nëse kjo e fundit vendos të nxjerrë ndonjë informacion, kur nxjerrin informacion, paraqesin: (i) një përshkrim të qartë dhe të përmbledhur të dokumenteve, ose kategorive të dokumenteve, që i janë nxjerrë palës tjetër; (ii) një kategorizim të informacionit të nxjerrë në përputhje me akuzat e Aktakuzës së Konfirmuar, duke iu referuar veprave penale konkrete që përbëjnë bazën e tyre, elementeve kontekstuale të veprave penale, veprimeve të pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provave që do të paraqiten nga ZPS-ja.

### IV. DISKUTIM

#### A. FORMATI DHE KATEGORIZIMI

8. Palët pajtohen për formatin dhe kategorizimin brenda tabelës së propozuar.<sup>15</sup>

9. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se tabela e propozuar bazohet në kategorizim individual të çdo prove të veçantë të nxjerrë, sipas elementeve kontekstuale, veprave penale bazë, veprimeve të të akuzuarve, provave në të cilat mbështetet ZPS-ja dhe nënkategorizimit të mëtejshëm sipas formave të përgjegjesisë

---

<sup>15</sup> Parashtrimi, para. 3-4. Z. Haradinaj rezervon të drejtën që të bëjë parashtrime të tjera pasi ta shohë tabelën e propozuar të plotësuar. Parashtrimi, poshtëshënimi 4.

penale.<sup>16</sup> Gjithashtu, palët propozojnë që të japin “referencë konkrete” në lidhje me secilën provë të veçantë, për ta informuar palën marrëse për pjesën e saktë përkatëse të provës.<sup>17</sup>

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se tabela e propozuar do ta ndihmojë Mbrojtjen në përgatitjet e saj dhe është në përputhje me standardin e kategorizimit që kërkohet në rregullën 109(c) të Rregullores.

#### B. META TË DHËNAT

11. ZPS-ja pajtohet që, për aq sa është e realizueshme, në kohën e nxjerrjes së informacionit, të kategorizojë çdo provë sipas veprës penale bazë, elementeve kontekstuale, veprimeve të të akuzuarve dhe/ose provave në të cilat mbështetet ZPS-ja (“Kategoritë e rregullës 109(c)”) në fushat e meta të dhënave në *Legal WorkFlow*.<sup>18</sup>

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se përdorimi i kategorive të rregullës 109(c) në fushat e meta të dhënave në kohën e nxjerrjes së materialeve, në lidhje me të gjithë materialin e nxjerrë, do të ofronte një pjesë të konsiderueshme të informacionit në tabelën e propozuar në kohën e nxjerrjes së informacionit dhe si pasojë do ta ndihmonte shumë Mbrojtjen në përgatitjet e saj.

13. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se palët përfshijnë kategoritë e rregullës 109(c) në meta të dhënat e të gjithë materialit të nxjerrë.

#### C. MATERIALI PËRKATËS

---

<sup>16</sup> Parashtrimi, para. 4, 8. Theksohet se veprat penale sipas nenit 15 të Ligjit nuk përfshijnë elementet kontekstuale.

<sup>17</sup> Tabela e propozuar.

<sup>18</sup> Parashtrimi, para. 9.

14. ZPS-ja parashtron se tabela e propozuar duhet të ketë lidhje vetëm me materialin e rregullës 102(1)(b), kurse për Mbrojtjen, në lidhje me materialin e nxjerrë në përputhje me rregullën 104(1) dhe (6) të Rregullores.<sup>19</sup> ZPS-ja argumenton se, nëse tabela e propozuar do të kishte të bënte me të gjithë materialin e nxjerrë, procesi i nxjerrjes së materialit do të pësonte vonesa të pashmangshme.<sup>20</sup> Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se përmbledhja sipas rregullës 86(3)(b) tashmë ofron analizë të gjerë në lidhje me materialin e rregullës 102(1)(a) dhe nuk ka asnjë dobi praktike që të paraqitet përsëri një material i tillë në formatin e tabelës së propozuar.<sup>21</sup> Mbrojtja parashtron se krahas materialit të rregullës 102(1)(b), tabela e propozuar përfshin edhe materialin e rregullës 102(1)(a) dhe rregullës 103.<sup>22</sup>

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, në kohën e dorëzimit të aktakuzës për konfirmim, ZPS-ja dorëzoi edhe përmbledhjen e detajuar të materialit mbështetës, sikurse kërkohet në rregullën 86(3)(b) të Rregullores (“përmbledhja e detajuar”).<sup>23</sup> Siç është përcaktuar në këtë dispozitë, përmbledhja e detajuar tregon lidhjen e çdo prove me secilën akuzë, sidomos për sa u përket veprimeve të të dyshuarit në lidhje me krimet e pretenduara. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se formati i përmbledhjes së detajuar i plotëson kriteret e rregullës 109(c) të Rregullores, meqenëse kriteret në lidhje me përmbajtjen dhe lidhshmërinë të përcaktuara me Rregullore janë të njëjta.<sup>24</sup> Për këtë arsye, nuk është e nevojshme që ZPS-ja ta përfshijë materialin e rregullës 102(1)(a) në tabelën e propozuar.

---

<sup>19</sup> Parashtrimi, para. 6.

<sup>20</sup> Parashtrimi, para. 7.

<sup>21</sup> Parashtrimi, para. 10.

<sup>22</sup> Parashtrimi, para. 6.

<sup>23</sup> KSC-BC-2020-07, F00063/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e parashtrimit të Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesa në lidhje me të*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale.

<sup>24</sup> *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje lidhur me to*, 9 nëntor 2020, publik, para. 71.

16. Sa i përket materialit të rregullës 103, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kompleksiteti i kufizuar faktik dhe ligjor i çështjes që ka të bëjë me krime të pretenduara sipas nenit 15 të Ligjit, e bën të panevojshme përfshirjen e këtij materiali në tabelën e propozuar. Sidoqoftë, siç është diskutuar më lart, kategorizimi i këtij materiali sipas rregullës 109(c) të Rregullores do të jetë i dobishëm meqë kategori të tilla do të përfshihen në fushat e meta të dhënave të secilit dokument gjatë nxjerrjes së informacionit. Si pasojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të mjaftueshme që fushat e meta të dhënave e përmbajnë kategorizimin dhe nuk e konsideron të nevojshme që i njëjti informacion të pasqyrohet përsëri në tabelën e propozuar.

17. Sa i përket Mbrojtjes, në rast se z. Gucati dhe/ose z. Haradinaj vendosin të nxjerrin prova në përputhje me rregullën 104(1) dhe (5) të Rregullores, ata duhet të paraqesin tabelën e propozuar për ta kategorizuar atë material.

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se palët kanë mundësi që të thërrasin dëshmitarë shtesë. Në raste të tilla, materiali që ka të bëjë me këta dëshmitarë dhe që është material i rregullave 102(2) dhe 104(6) të Rregullores, duhet gjithashtu të përfshihet në tabelën e propozuar ose në një shtesë të saj, në kohën e nxjerrjes përkatëse të materialit.

19. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se tabela e propozuar përfshin materialin e rregullave 102(1)(b) dhe 102(2), sa i përket ZPS-së, dhe materialin e rregullës 104(1), (5) dhe (6) sa i përket Mbrojtjes.

#### D. AFATET

20. ZPS-ja parashtron që tabela e propozuar të dorëzohet brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të cilësdo dosje paraprake.<sup>25</sup> Mbrojtja kërkon që tabela e propozuar e ZPS-së të dorëzohet deri më 19 shkurt 2021 dhe që ZPS-ja të paraqesë dhe përditësojë versionin përmbledhës të tabelës së propozuar në çdo nxjerrje të re të materialit.<sup>26</sup>

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh formulimin elastik të rregullës 109 të Rregullores dhe veçoritë e çështjes gjyqësore aktuale, përfshirë kompleksitetin e çështjes dhe afatet për nxjerrjen e informacionit.<sup>27</sup> Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se çështja aktuale ka kompleksitet të kufizuar faktik dhe ligjor, meqenëse ka të bëjë me krime sipas nenit 15(2) të Ligjit me fushëveprim të kufizuar kohor dhe gjeografik.<sup>28</sup> Gjithashtu, në përputhje me Vendimin kornizë mbi nxjerrjen e provave, ZPS-ja duhet të nxjerrë të gjithë materialin e rregullës 102(1)(b) deri më 19 shkurt 2021.<sup>29</sup> Në mënyrë që të mos çrregullohet ecuria e nxjerrjes së informacionit, dhe duke mbajtur parasysh efikasitetin në përpilimin e tabelës së propozuar rreth afatit të dorëzimit të dosjes paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se mënyra më e shpejtë e procedimit në çështjen aktuale është që tabela e propozuar t'i jepet palës kundërshtare në kohën e dorëzimit të cilësdo dosjeje paraprake.

22. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron palët që të nxjerrin tabelën e propozuar në kohën e dorëzimit të dosjeve paraprake përkatëse.

---

<sup>25</sup> Parashtrimi, para. 3, 12(a).

<sup>26</sup> Parashtrimi, para. 6.

<sup>27</sup> *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-05, F00046, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rishikim ose leje për apelim*, 5 nëntor 2020, publik, para. 17.

<sup>28</sup> Vendimi i konfirmimit, para. 103, 109, 113, 117, 121, 125.

<sup>29</sup> Vendimi kornizë mbi nxjerrjen e provave, para. 85(b).



## V. VENDIM

23. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** tabelën e propozuar për nxjerrjen e materialeve në çështjen aktuale;
- b. **MIRATON** përdorimin e kategorive të rregullës 109(c) në fushën e meta të dhënave për secilin material;
- c. **VENDOS** që tabela e propozuar të përfshijë, sa i përket ZPS-së, materialin e rregullës 102(1)(b) dhe 102(2), dhe sa i përket Mbrojtjes, materialin që nxirret në përputhje me rregullën 104(1), (5) dhe (6) të Rregullores; dhe
- d. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen, nëse kjo e fundit vendos që të nxjerrë ndonjë provë, që të dorëzojnë tabelën e propozuar brenda një jave pas dorëzimit të dosjeve paraprake.

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/\_\_\_\_

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E enjte, 11 shkurt 2021

Në Hagë, Holandë.